



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.113

22 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Prokurimeve për vitin 2007	4963
Ligj nr.9937 datë 26.6.2008	Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin	4963
Ligj nr.9938 datë 26.6.2008	Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.....	4977
Ligj nr.9939 datë 26.6.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e pjesshme, të zgjeruar, në sport (EPAS)”	4991
Ligj nr.9940 datë 26.6.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen Europiane për zbatimin e nenit 23 të Konventës së vitit 1949 për trafikun rrugor, në lidhje me përmasat dhe peshën e mjeteve, që lejohen të udhëtojnë në rrugë të caktuara të palëve kontraktuese”...	4996
Ligj nr.9941 datë 26.6.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kontributit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Al-Diwan Al-Emirit të shtetit të Kuvajtit për financimin e projektit “Rinovimi i sheshit “Skënderbej” dhe restaurimi i Xhamisë së Ethem Beut në Tiranë”.	5001
Udhëzim i MASH nr.25, datë 7.7.2008	Për kriteret profesionale dhe procedurat e konkursit për zgjedhjen e trembëdhjetë anëtarëve ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar	5003

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- duke njohur e vlerësuar rolin e Avokatit të Prokurimeve për mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomikë, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për prokurimin publik dhe për koncesionet;

- duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera brenda e jashtë vendit,

Vlerëson veprimtarinë e institucionit për periudhën maj-dhjetor 2007 për:

- përzgjedhjen e një stafi profesional me përvojë në fushën e prokurimeve e atë administrative dhe me njohuri në fushën e legjislacionit;

- ngritjen dhe organizimin e institucionit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore e nënligjore;

- shqyrtimin e ankesave të depozituara nga operatorët ekonomikë, kryerjen e hetimit administrativ dhe marrjen e vendimeve në përputhje me ligjin.

Kuvendi kërkon që për vitin 2008 Avokati i Prokurimeve të zbatojë këto detyrime:

- rritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit të institucionit në drejtim të mbrojtjes së interesave të kandidatëve, ofertuesve e furnizuesve në fushën e prokurimit publik dhe koncesioneve;

- konsolidimin e strukturës së institucionit, zgjerimin e veprimtarisë trajnuese dhe ngritjen profesionale të specialistëve;

- rritjen e bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, Kontrollin e Lartë të Shtetit, organet ekzekutive dhe Kuvendin për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni për prokurimin publik dhe për koncesionet, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të tij;

- hartimin e rregullores së institucionit, ngritjen e regjistrit publik të ankesave dhe vënien e tij në dispozicion të publikut;

- hartimin dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit, në përputhje me Marrëveshjen e Sfidës së Mijëvjeçarit.

7 korrik 2008

LIGJ
Nr.9937, datë 26.6.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5800, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTË

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LETONISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË
DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË
ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Letonisë,
me dëshirën, që me qëllim zhvillimin dhe lehtësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të tyre
ekonomike, për të përfunduar një Konventë për mënjanimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e
evazionit fiskal në lidhje me taksat mbi të ardhurat dhe kapitalin,
kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Personat e përfshirë

Kjo Konventë zbatohet për personat që janë rezidentë në njërin ose në të dy Shtetet
Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Konventë zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vihet nga ana e një
Shteti Kontraktues ose autoriteteve vendore, pavarësisht nga mënyra e mbledhjes së tyre.

2. Tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin konsiderohen të gjitha tatimet që vihen mbi të
ardhurat e plota, kapitalin e plotë ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë këtu
tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme ose të paluajtshme, si edhe tatimet mbi
vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Konventa janë veçanërisht:

a) në Shqipëri:

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin e personave juridikë dhe tatimin mbi të
ardhurat personale);

ii) tatimi mbi veprimtaritë e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pronën;

(këtu "tatim shqiptar");

b) në Letoni:

i) tatimi mbi të ardhurat e personave juridikë (uznemumu ienakuma nodoklis);

ii) tatimi mbi të ardhurat personale (iedzivotaju ienakuma nodoklis); dhe

iii) tatimi mbi pasuritë e paluajtshme (nekustama ipasuma nodoklis);

(këtu "tatim letones").

4. Konventa zbatohet gjithashtu edhe për çdo tatim identik apo shumë të ngjashëm që vihet
pas datës së nënshkrimit të Konventës, përveç ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet
kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që
është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termat "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Shqipërinë ose

Letoninë;

b) termi “Shqipëri” do të thotë Republika e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tjetër përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, sipas legjislacionit të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda të cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi “Letoni” do të thotë Republika e Letonisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Republikës së Letonisë dhe çdo zonë tjetër pranë ujërave territoriale të Republikës së Letonisë brenda të cilave në bazë të ligjeve të Letonisë dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të drejtat e Letonisë mund të ushtrohen në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

d) termi “person” përfshin një individ, shoqëri ose çdo grup tjetër personash;

e) termi “shoqëri” do të thotë çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi “shtetas” do të thotë:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri apo shoqatë që ka statusin e saj si të tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

h) termi “trafik ndërkombëtar” do të thotë çdo transport me anije ose avion që operohet nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues, përveçse kur anija ose avioni operon vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

i) termi “autoriteti kompetent” do të thotë:

i) në Shqipëri: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

ii) në Letoni: Ministria e Financave ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj.

2. Në lidhje me zbatimin e Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar këtu, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet Konventa, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti që ka epërsi mbi kuptimin që merr termi sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllimet e Konventës, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” do të thotë çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve për shkak të vendbanimit të përhershëm, vendbanimit të përkohshëm, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose ndonjë kriteri tjetër të kësaj natyre dhe përfshin gjithashtu atë shtet dhe autoritet vendor të tij. Ky term, megjithatë, nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimeve në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka banesë të përhershme; nëse ka një banesë të përhershme në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin marrëdhëniet e tij personale dhe ekonomike janë më të afërta (qendra e interesave jetësore);

b) nëse shteti ku ka qendrën e interesave të tij jetësore nuk mund të përcaktohet, ose nëse ai nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë prej shteteve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka banesën e zakonshme;

c) nëse ka një banesë të zakonshme në të dy shtetet ose në asnjë prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dy shteteve, ose i asnjërit prej tyre, autoritetet përgjegjëse të Shteteve Kontraktuese zgjidhin çështjen me marrëveshje reciproke.

3. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1 një person, i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese përpiqen ta zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët dhe përcaktojnë mënyrën e zbatimit të Konventës për këtë person. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, për qëllimet e Konventës, personi nuk e ka të drejtën e pretendimit të përfitimeve të parashikuara nga kjo Konventë.

Neni 5

Selia e përhershme

1. Për qëllim të kësaj Konvente, termi “seli e përhershme” do të thotë një vend i qëndrueshëm biznesi nëpërmjet të cilit drejtohet krejtësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në mënyrë të veçantë:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, gurore ose çdo vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” përfshin gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo veprimtari mbikëqyrëse në lidhje me to, por vetëm atje ku ky kantier, projekt apo veprimtari vazhdon më shumë se nëntë muaj;

b) ofrimin e shërbimeve, përfshirë këtu shërbime konsultimi, nga një ndërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur veprimtaritë e kësaj natyre vazhdojnë brenda Shtetit Kontraktues për një periudhë ose periudha që së bashku arrijnë në tërësi më shumë se 6 muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “filial i përhershëm” do të konsiderohet se nuk përfshin:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes së të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes;

c) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të blerjes së të mirave ose mallrave, ose për mbledhje informacioni për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për ndërmarrjen, të çdo veprimtarie tjetër të natyrës përgatitore ose mbështetëse;

f) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për kombinim të veprimtarive të përmendura në nënparagrafët “a” deri në “e” me kusht që veprimtaria në përgjithësi e një vendi të caktuar biznesi që rezulton nga ky kombinim të ketë natyrë përgatitore ose mbështetëse.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, ku një person - përveçse një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6 - vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, dhe zakonisht e ushtron, në një Shtet Kontraktues, autoritetin për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo veprimtari që ai person kryen për ndërmarrjen, nëse veprimtaritë e këtij personi nuk kufizohen me ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të qëndrueshëm biznesi, nuk do ta bënin këtë vend të qëndrueshëm biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet se ka filial të përhershëm në një Shtet Kontraktues vetëm sepse kryen biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me kompetencë të përgjithshme ose agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë sipas rrjedhës së zakonshme të biznesit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri, rezidente në një Shtet Kontraktues, kontrollon ose kontrollon nga një shoqëri që është rezidente në Shtetin tjetër Kontraktues, ose që ushtron biznes në shtetin tjetër

(nëpërmjet një selie të përhershme ose tjetër) nuk përbën në vetvete as shoqëri dhe asnjë seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatonen në shtetin tjetër.

2. Termi “pronë e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet pasuria në fjalë. Termi në çdo rast përfshin sendet aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet që përdoren në bujqësi dhe pyje, të drejta për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të përgjithshëm në lidhje me pasurinë tokësore, uzufruktin e pronës së paluajtshme dhe të drejta për pagesa të ndryshueshme ose të pandryshueshme si shpërblim për funksionimin e, ose të drejtën për punë, depozita minerare, burime dhe burimeve të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk konsiderohen pronë e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia në përdorim apo përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme, si dhe nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme.

4. Nëse pronësia e aksioneve ose të drejtave të tjera të një shoqërie i japin të drejtë pronarit të këtyre aksioneve ose të drejtave për gëzimin e pasurisë së paluajtshme që zotërohet nga shoqëria, të ardhurat nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia në përdorim ose përdorimi në një formë tjetër i këtyre të drejtave të gëzimit mund të tatonen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 3 dhe 4 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues tatonen vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje. Nëse ndërmarrja kryen biznes si më lart, fitimet e ndërmarrjes mund të tatonen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë që i atribuohet atij filiali të përhershëm.

2. Sipas dispozitave të paragrafit 3, nëse një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, këtij filiali të përhershëm në çdo Shtet Kontraktues do t'i atribuohen fitimet që mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë e përfshirë në veprimtari të njëjta ose të ngjashme sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe nëse merrej tërësisht dhe në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja, filial i së cilës është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një filiali të përhershëm në një Shtet Kontraktues, do të lejohen, si zbritje shpenzimet (përveç shpenzimeve që nuk do të ishin të zbritshme nëse ky filial i përhershëm do të ishte një ndërmarrje e veçantë e një Shteti Kontraktues) që janë bërë për qëllime të filialit të përhershëm, përfshirë këtu shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative që janë bërë qoftë në shtetin ku ndodhet filiali i përhershëm, qoftë diku tjetër.

4. Për aq sa është e zakonshme në një Shtet Kontraktues të përcaktojë fitimet që i atribuohen një filiali të përhershëm në bazë të pjesës së fitimeve totale të ndërmarrjes me pjesët e saj të ndryshme, asnjë dispozitë në paragrafin 2 nuk do të pengojë Shtetin Kontraktues për të përcaktuar fitimet që do të tatonen nga një ndarje e tillë siç mund të jetë e zakonshme; metoda e miratuar e ndarjes, megjithatë, do të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë përfitim nuk do t'i atribuohet një filiali të përhershëm për shkak të blerjes nga ky filial i përhershëm i të mirave dhe mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, përfitimet që do t'i atribuohen filialit të përhershëm do të përcaktohen me të njëjtën mënyrë vit pas viti, nëse nuk ka arsye të plotë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zëra të të ardhurave që trajtohen në mënyrë të veçantë në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e këtyre neneve nuk do të preken nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje në një Shtet Kontraktues nga operimi i anijeve ose i avionëve në trafikun ndërkombëtar taten vetëm në atë shtet.

2. Për qëllimet e këtij neni, fitimet nga operimi i anijeve ose i avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë:

a) fitimet nga dhënia me qira e anijeve ose avionëve pa ekuipazh; ose

b) fitimet nga përdorimi, mbajtja ose dhënia me qira e kontenierëve (duke përfshirë trailerat dhe pajisjet përkatëse për transportimin e kontenierëve) të përdorur për transportin e të mirave dhe mallrave;

nëse kjo dhënie me qira ose përdorim apo mirëmbajtje, sipas rastit, është shoqëruese e operimit të anijeve ose avionëve nga ndërmarrja në trafikun ndërkombëtar.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 zbatohen gjithashtu edhe për fitimet nga pjesëmarrja në një konsorcium, biznes të përbashkët, apo agjenci operative ndërkombëtare.

Neni 9

Ndërmarrjet e asociuara

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast janë krijuar ose vënë kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, që dallojnë nga ato që do të ishin krijuar ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë të gjitha fitimet, që do të ishin nxjerrë, nëse nuk do të ishin ato kushte, nga një ndërmarrje, por, që për shkak të atyre kushteve, nuk janë nxjerrë si të tilla, mund të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të taten rregullisht.

2. Nëse një Shtet Kontraktues përfshin në përfitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti – dhe taton sipas tyre- fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në shtetin tjetër dhe fitimet e përfshira janë fitime që do të ishin mbledhur nga ndërmarrja e shtetit të parë të përmendur nëse kushtet e vëna ndërmjet të dyja ndërmarrjeve do të ishin ato që do t'u ishin vënë ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm për shumën e tatimit të vënë mbi këto fitime. Në përcaktimin e këtyre rregullimeve, dispozitat e tjera të kësaj Konvente do të konsiderohen në mënyrën e duhur dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultojnë njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët që një shoqëri rezidente e një Shteti Kontraktues i paguan një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten në Shtetin Kontraktues ku është rezidente shoqëria që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i caktuar nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga një ortakëri) që mban direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk prek tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet prej të cilave paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë” sipas përdorimit në këtë nen do të thotë të ardhura nga aksione të çdo lloji apo të drejta të tjera, që nuk janë pretendime borxhi, të cilat marrin pjesë në fitime, si edhe të

ardhura nga të drejta të tjera që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhura nga aksionet sipas ligjeve të shtetit ku është rezidente shoqëria që bën shpërndarjen.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku është rezidente shoqëria që paguan dividendë nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe duke pasur parasysh këto dividendë paguhen efektivisht në lidhje me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Nëse një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, Shteti tjetër nuk mund të vendosë ndonjë taksë mbi dividendët që paguan shoqëria, përveçse për sa kohë që këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër, ose për sa kohë, duke pasur parasysh këta dividendë paguhen efektivisht në lidhje me një filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme në shtetin tjetër, as t'ia nënshtrojnë fitimin e pashpërndarë të shoqërisë një tatimi mbi fitimin e pashpërndarë të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimi i pashpërndarë përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga fitimet ose të ardhurat që nxirren në shtetin tjetër.

Neni 11

Interesi

1. Interesi që del në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto honorarë mund të tatohet gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku del dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues; tatimi i caktuar nuk kalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të interesit që del në një Shtet Kontraktues dhe që paguhet për çdo hua të çdo lloji të dhënë nga një bankë;

b) 10 për qind të shumës së interesit në të gjitha rastet e tjera.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që del në një Shtet Kontraktues dhe përfitohet nga qeveria e Shtetit tjetër Kontraktues, duke përfshirë autoritetet lokale të tij, banka qendrore ose një institucion financiar që është në pronësi të plotë të asaj qeverie, apo interesi i paguar në lidhje me një hua të garantuar nga ajo qeveri apo autoritet përjashtohet nga tatimi në shtetin e parë.

4. Termi “interes” i përdorur në këtë nen do të thotë të ardhura nga pretendimi i borxhit të çdo lloji, të siguruara apo jo me hipotekë, dhe me të drejtë apo jo për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhura nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhura nga bonot ose detyrimet, përfshirë primet dhe çmime që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, bonove apo detyrimeve. Termi “interes” nuk përfshin të ardhurat që trajtohen si dividendë në bazë të dispozitave të nenit 10. Vënia e gjobave për vonesa në pagesa nuk do të konsiderohen si interes për qëllim të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku del interesi, nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilën paguhet interesi është i lidhur efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në një rast të tillë zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

6. Interesi konsiderohet se ka dalë në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Sidoqoftë, nëse personi që paguan interesin, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues, apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një sipërmarrje të përhershme ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi mbi të cilin është paguar interesi dhe ky interes ka dalë nga ky filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë ky interes do të konsiderohet se ka dalë në shtetin ku ndodhet filiali i përhershëm ose baza e qëndrueshme.

7. Nëse, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin ai paguhet, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12 **Honorarët**

1. Honorarët që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i honorarëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk kalon 5% të shumës bruto të tarifës për licencë.

3. Termi “honorarë”, siç përdoret në këtë nen, do të thotë pagesa të çdo lloji që merren si një shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për vepra letrare, artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, filmat ose kasetat për transmetim në radio apo televizion, çdo patentë, markë, skicë apo model, plan, formulë sekrete apo proces, apo për përdorimin ose për të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i honorarëve, duke qenë rezident në një Shtet Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku lindin honorarët, nëpërmjet një filiali të përhershëm ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen honorarët lidhet efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14.

5. Honorarët konsiderohen që kanë lindur në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Sidoqoftë, kur personi që paguan honorarët, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një filial të përhershëm ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi për të paguar honorarët dhe ky honorar ka lindur nga ky filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë këto honorarë do të konsiderohen se kanë lindur në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza e caktuar.

6. Nëse, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e honorarëve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin janë paguar, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13 **Fitimet kapitale**

1. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i aksioneve ose nga një interes i krahasueshëm i çdo lloji duke nxjerrë më shumë se 50% të vlerës së tyre direkt apo indirekt nga pasuria e paluajtshme që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që janë pjesë e pronës së biznesit të një filiali të përhershëm që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të një prone të luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, përfshirë këtu fitimet nga tjetërsimi i këtij filiali të përhershëm (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose i kësaj baze të qëndrueshme, mund të tatohen në shtetin tjetër.

4. Fitimet e përftuara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues që operon anije ose avionë në trafikun ndërkombëtar nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pronës së luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër, përveç atyre të përmendura në paragrafët e mësipërm të këtij neni, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku tjetërsuesi është rezident.

Neni 14

Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat që përfitohen nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbime profesionale ose të tjera të ngjashme të natyrës së pavarur, tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur ai ka një bazë të qëndrueshme në zotërim të tij të përhershëm në shtetin tjetër Kontraktues për të kryer veprimtarinë e tij. Nëse ai ka një bazë të tillë të qëndrueshme, të ardhurat mund të tatohen në shtetin tjetër vetëm në masën që i përket kësaj baze të qëndrueshme. Për këtë qëllim, nëse një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues qëndron në shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë ose periudha që në tërësi i kalojnë 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin fiskal në fjalë, ai mendohet të ketë pasur një bazë të qëndrueshme në zotërim të tij të përhershëm në atë shtet tjetër dhe të ardhurat që përfitohen nga aktivitetet e përmendura më sipër që kryhen në shtetin tjetër i caktohen asaj baze të qëndrueshme.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht veprimtari të pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative apo mësimdhënie, si dhe veprimtari të pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

Shërbime personale të varura

1. Sipas dispozitave të neneve 16, 18 dhe 19, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfiton një rezident i një Shteti Kontraktues për një punësim tatohen vetëm në atë shtet, përveçse kur punësimi është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet kështu, ky shpërblim që rrjedh prej tij mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi që përfiton një rezident i një Shteti Kontraktues për punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues tatohet vetëm në shtetin e përmendur më parë nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në tërësi 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin financiar në fjalë; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident në shtetin tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk mbulohet nga një filial i përhershëm ose një bazë e qëndrueshme që ka punëdhënësi në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi që del për punësimin e ushtruar në bordin e një anijeje apo avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues mund të tatohet në atë shtet.

Neni 16

Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose të një organi tjetër të ngjashëm të një shoqërie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht dispozitave të neneve 14 dhe 15, të ardhurat që përfitohen nga një rezident në një Shtet Kontraktues si një argëtues, artist teatri, filmi, radioje apo televizioni, ose muzikant, apo sportist në veprimtarinë e tij personale të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Nëse të ardhurat në lidhje me veprimtaritë personale të ushtruara nga një argëtues apo sportist në cilësinë e tij si i tillë nuk mbledhen për argëtuesin apo sportistin, por për një person tjetër, këto të ardhura mund të tatohen, pavarësisht dispozitave të neneve 7, 14 dhe 15, në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti ushtron veprimtarinë e tij.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që përfitohen nga një argëtues

ose sportist prej veprimtarive të ushtruara në një Shtet Kontraktues nëse vizita në atë Shtet mbështetet plotësisht ose pjesërisht nga fondet publike të një ose të dy Shteteve Kontraktues, ose apo autoriteteve vendore të tyre. Në këtë rast, të ardhurat taten vetëm në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti është rezident.

Neni 18 **Pensionet**

1. Sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues për punësimin në të kaluarën, taten vetëm në atë shtet.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni dhe paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara në bazë të sistemit shtetëror të sigurimeve sociale të një Shteti Kontraktues taten vetëm në atë shtet.

Neni 19 **Shërbimet qeveritare**

1. a) Pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, përveç pensionit, që një Shtet Kontraktues, apo autoritet vendor i paguan një individ në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo autoriteti, taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të ngjashme taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë bërë në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti:

i) ku është shtetas, ose

ii) kur nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues apo autoritet vendor për një individ në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo atij autoriteti, do të taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është rezident ose shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 zbatohen për pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme dhe për pensionet, në lidhje me shërbimet që janë kryer për një biznes të kryer nga një Shtet Kontraktues ose autoritet vendor i tij.

Neni 20 **Studentët dhe stazhierët**

1. Pagesat që merr një student, stazhier ose nxënës që është ose ishte menjëherë para vizitës së një Shteti Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllimet e arsimit të tij ose të shërbimeve të trajnimit për qëllimin e jetesës, arsimit ose trajnimit nuk taten në atë shtet, me kusht që këto pagesa të vijnë nga burimet jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me pagesat që nuk mbulohen nga paragrafi 1 i këtij neni dhe shpërblimin për shërbimet e varura personale të dhëna gjatë këtij arsimit apo trajnimit, një student, stazhier ose nxënës ka të drejtën e të njëjtave përjashtime, përfitime ose zbritje në lidhje me taksat për të ardhurat që ofrohen për rezidentët e Shtetit Kontraktues ku ai është me vizitë.

Neni 21 **Veprimtaria jashtë territorit**

1. Dispozitat e këtij neni zbatohen pavarësisht dispozitave të neneve 5 deri 20 të kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e këtij neni, termi “aktivitete jashtë territorit” do të thotë aktivitete që kryhen jashtë territorit të një Shteti Kontraktues në lidhje me kërkimin ose shfrytëzimin e shtratit të detit dhe nëntokës dhe burimeve të tyre natyrore që ndodhen në atë shtet.

3. Një person që është rezident i një Shteti Kontraktues dhe kryhen aktivitete jashtë territorit në Shtetin tjetër Kontraktues, në pajtim me paragrafin 4, mendohet të kryejë biznes në atë shtet tjetër me anë të një filiali të përhershëm ose baze të qëndrueshme që ndodhet atje.

4. Dispozitat e paragrafit 3 nuk zbatohen nëse aktivitetet jashtë territorit kryhen për një periudhë ose periudha që në tërësi nuk i kalojnë 30 ditë në çdo periudhë 12-mujore. Për qëllimet e këtij paragrafi:

a) aktivitetet jashtë territorit të kryera nga një person që është i asociuar me një person tjetër mendohen të jenë kryer nga personi tjetër nëse aktivitetet në fjalë janë thelbësisht të njëjta si ato të kryera nga personi i parë, përveç deri në masën që ato aktivitete kryhen në të njëjtën kohë si aktivitetet e veta;

b) një person mendohet të jetë i asociuar me një person tjetër nëse njëri kontrollohet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga tjetri, ose të dy kontrollohen drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga një ose disa persona të tretë.

5. Pagat ose shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim që ka të bëjë me një aktivitet jashtë territorit në Shtetin tjetër Kontraktues, në masën që detyrat kryhen jashtë territorit në shtetin tjetër, taten nga ai shtet. Megjithatë, një shpërblim i tillë tatohet vetëm në shtetin e parë, nëse punësimi kryhet për një punëdhënës që nuk është rezident i shtetit tjetër dhe për një periudhë ose periudha që në tërësi nuk i kalojnë 30 ditë në një periudhë 12-mujore.

6. Fitimet që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi:

a) i të drejtave të kërkimit ose shfrytëzimit; ose

b) i pasurisë që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues që përdoret në lidhje me aktivitetet jashtë territorit të kryera në shtetin tjetër; ose

c) i aksioneve që e marrin vlerën e tyre ose pjesën më të madhe të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt nga këto të drejta ose kjo pasuri ose nga ato të drejta dhe pasuri të marra së bashku, mund të tatohen në shtetin tjetër.

Në këtë paragraf termi “kërkimi ose të drejtat e kërkimit” do të thotë të drejtat për sendet pasurore që prodhohen nga aktivitetet jashtë territorit që kryhen në Shtetin tjetër Kontraktues, ose interesat apo përfitimet e këtyre sendeve pasurore.

Neni 22

Të ardhura të tjera

1. Zëra të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kurdo që lindin, që nuk janë trajtuar në nenet e mësipërme të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhura, përveç të ardhurave nga prona e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje, dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilën paguhen të ardhurat lidhet efektivisht me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14 sipas rastit.

Neni 23

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme përmendur në nenin 6, në pronësi të një rezidenti të një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri e luajtshme që bën pjesë në pronën e biznesit të një filiali të përhershëm që një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga prona e luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, mund të tatohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet ose avionët që operohen në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues dhe nga prona e luajtshme që i përket funksionimit të këtyre anijeve apo avionëve tatohet vetëm në atë shtet.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë shtet.

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në Shqipëri tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatóhet në Letoni, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Letoni;

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Letoni.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatóhet në Letoni.

b) Nëse në përputhje me çdo dispozitë të Konventës, të ardhurat e përfutuara ose kapitali në pronës të një rezidenti të Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, pavarësisht nga kjo, Shqipëria, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat apo kapitalin që mbetet për këtë rezident, merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Letoni tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Letonisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatóhet në Shqipëri, nëse në bazë të ligjit të vet nuk i jepet një trajtim më i favorshëm, Letonia do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri;

ii) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin në Letoni, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatóhet në Shqipëri.

b) Për qëllimet e nënparagrafit a), nëse një shoqëri që është rezidente e Letonisë merr një dividend nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë ku ajo ka në pronësi të paktën 10 për qind të aksioneve të saj që kanë të drejta të plota vote, tatimi i paguar në Shqipëri përfshin jo vetëm tatimin e paguar për dividendin, por gjithashtu edhe pjesën e përshtatshme të tatimit të paguar për fitimet përkatëse të shoqërisë nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Nëse një pajtim me ligjin e Shtetit Kontraktues lejohet një përjashtim ose zvogëlim i tatimeve të rregulluara nga kjo Konventë për qëllimin e inkurajimit të zhvillimit ekonomik në atë Shtet Kontraktues, tatimi që do të ishte paguar nëse nuk do të ishte ky përjashtim ose zvogëlim mendohet të jetë paguar për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni. Kjo dispozitë zbatohet vetëm për dhjetë vitet e para gjatë të cilëve është në fuqi kjo Konventë. Kjo periudhë mund të zgjatet me marrëveshje reciproke ndërmjet autoriteteve kompetente. Shtetet Kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin për një marrëveshje të tillë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues asnjë tatimi apo kërkesë që lidhet me të, që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilat u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, sidomos në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet gjithashtu për personat që nuk janë rezidentë të njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi, që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues, nuk do t'i nënshtrohen në asnjë Shtet Kontraktues tatimit apo kërkesës në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, sidomos në lidhje me rezidencën.

3. Tatimi mbi një filial të përhershëm që ka një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues në Shtetin

tjetër Kontraktues nuk do të mblidhet në shtetin tjetër me më pak favorizim sesa tatimi që mblidhet nga ndërmarrjet e shtetit tjetër që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim për Shtetin Kontraktues që t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihmë personale, lehtësime dhe reduktime për qëllime tatimore në emër të gjendjes civile apo përgjegjësive familjare që u jep rezidentëve të tij.

4. Përveçse kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 neni 9, paragrafit 7 neni 11, apo paragrafit 6 neni 12, interesat, tarifat për licencë, dhe disbursime të tjera që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues nga një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues, me qëllim që të përcaktohen fitimet e tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të reduktohen me të njëjtat kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur. Po kështu, çdo detyrim i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues për një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim që të përcaktohet kapitali i tatueshëm i kësaj ndërmarrjeje do të reduktohet sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur.

5. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose kontrollohet tërësisht apo pjesërisht, direkt apo indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen në shtetin e parë të përmendur tatimit apo kërkesës tjetër të lidhur me të që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të ngjashme të shtetit të parë të përmendur.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 26

Procedura e marrëveshjes reciproke

1. Nëse një person konsideron që veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, ai, pavarësisht nga mjetet e parashikuara në të drejtën e brendshme të atyre shteteve, mund të paraqesë çështjen e tij tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku është rezident, ose, nëse çështja e tij është sipas paragrafit 1 të nenit 25, te Shteti Kontraktues ku ai është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tri viteve nga njoftimi i parë i veprimit që ka rezultuar në vënien e tatimit që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent përpiqet, nëse kundërshtimi duket i justifikuar, dhe nëse nuk është e mundur të arrihet një zgjidhje e kënaqshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje reciproke me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim për të shmangur tatimin që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e përfunduar do të zbatohet pavarësisht kufizimeve kohore në të drejtën e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje reciproke vështirësitë apo dyshimet që lindin për interpretimin ose shpjegimin e Konventës. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në Konventë.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund t'i komunikojnë njëri-tjetrit direkt qëllimet për arritjen e një marrëveshjeje sipas kuptimit të paragrafëve të mësipërm, edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët që përbëhet prej tyre përfaqësuesve të tyre.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente apo ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi që vihen në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të autoriteteve vendore, përsa kohë që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 dhe 2. Çdo informacion që merret nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe do t'i jepet vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen, apo zgjidhjen e ankesave në lidhje me tatimet e

përmendura në fjalinë e parë. Këto persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të japin këtë informacion në procedime gjyqësore publike ose në vendime gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në mënyrë që t'i imponojnë një Shteti Kontraktues detyrimin:

a) për të marrë masa administrative në përputhje me ligjet dhe praktikat administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) për të siguruar informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose në rrugën normale të administratës të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) për të siguruar informacion që do të zbulonte ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, apo profesional apo proces tregtie, ose informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikat publike (rend publik).

Neni 28

Anëtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Qeveritë e Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën që janë plotësuar procedurat e tyre ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente.

2. Konventa hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 dhe të gjitha dispozitat e saj kanë efekt në të dy Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 janar ose pas 1 janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës kur ka hyrë në fuqi Konventa;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, kapitalin, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari i vitit kalendarik pas vitit të hyrjes në fuqi të Konventës.

Neni 30

Prishja

Kjo Konventë mbetet në fuqi derisa të priset nga një Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të prishë Konventën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, duke bërë një njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj përpara fundit të çdo viti kalendarik, pas periudhës pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në këtë rast, Konventa nuk do të ketë më fuqi në të dy Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen më 1 janar ose pas 1 janarit të vitit të ardhshëm kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, kapitalin, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari dhe pas tij të vitit pasardhës kalendarik pas vitit kur është dhënë njoftimi.

Si dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, me autoritet të plotë për këtë, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 21 dita e shkurtit 2008, në shqip, letonisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njësoj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

LIGJ

Nr.9938, datë 26.6.2008

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL,

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5801, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTË

**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË
DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT
DHE KAPITALIN**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Sllovenisë, me dëshirën për të lidhur një konventë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Personat e përfshirë

Kjo Konventë zbatohet për personat që janë rezidentë në njërin ose në të dy Shtetet Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Konventë zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin që vihet nga ana e një Shteti Kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve vendore, pavarësisht nga mënyra e mbledhjes së tyre.

2. Tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin konsiderohen të gjitha tatimet që vihen mbi të ardhurat totale ose mbi elemente të të ardhurave apo të kapitalit, përfshirë këtu tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumën e plotë të pagave apo rrogave që paguhet nga ndërmarrjet, si edhe tatimet mbi kapitalin e vlerësuar.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Konventa janë në veçanti:

a) në Shqipëri;

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi përfitimin e korporatës dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

- ii) tatimi mbi veprimtaritë e biznesit të vogël;
 - iii) tatimi mbi pronën;
 - (tani e më poshtë si “tatim shqiptar”);
 - b) në Slloveni:
 - i) tatimi mbi të ardhurat e personave juridikë;
 - ii) tatimi mbi të ardhurat e individëve;
 - iii) tatimi mbi pronën;
 - (tani e më poshtë si “tatim slloven”).
4. Konventa zbatohet gjithashtu edhe për çdo tatim identik apo shumë të ngjashme që vihet pas datës së nënshkrimit të Konventës përveç ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që është bërë në legjislacionin e tyre tatimor.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllime të kësaj Konvente, nëse konteksti nuk kërkon ndryshe:
- a) termi “Shqipëri” do të thotë Republika e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Shqipërisë, përfshirë këtu ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tjetër përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas legjislacionit të saj dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda të cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;
 - b) termi “Slloveni” do të thotë Republika e Sllovenisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, do të thotë territori i Sllovenisë, si dhe zonat detare mbi të cilat Sllovenia mund të ushtrojë të drejta sovraane apo të drejta juridiksioni në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe ndërkombëtar.
 - c) termat “Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë Shqipërinë ose Slloveninë, sipas kontekstit;
 - d) termi “person” përfshin një individ, kompani ose çdo grup tjetër personash;
 - e) termi “kompani” do të thotë çdo person juridik ose strukturë apo çdo njësi që trajtohet si një strukturë për qëllime tatimore;
 - f) termat “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e një Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;
 - g) termi “trafik ndërkombëtar” do të thotë çdo transport me anije, avion apo automjet rrugor nga një ndërmarrje që e ka vendin e menaxhimit efikas në një Shtet Kontraktues, përveçse kur anija, avioni apo automjeti rrugor operon vetëm ndërmjet vendeve në Shtetit tjetër Kontraktues;
 - h) termi “autoriteti kompetent” do të thotë:
 - i) në Shqipëri: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - ii) në Slloveni: Ministria e Financave të Republikës së Sllovenisë ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj;
 - i) termi “shtetas” në lidhje me një Shtet Kontraktues, do të thotë:
 - i) çdo individ që ka kombësinë e një Shteti Kontraktues;
 - ii) çdo person juridik, ortakëri apo shoqatë që ka statusin e saj si të tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Në lidhje me zbatimin e Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar këtu, nëse konteksti nuk parashikon ndryshe, ka kuptimin që nënkupton në atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet Konventa, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti që ka epërsi mbi kuptimin që merr termi sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

Neni 4

Rezidenti

1. Për qëllimet e Konventës, termi “rezident i Shtetit Kontraktues” do të thotë çdo person që,

sipas ligjeve të atij shteti, i nënshtrohet tatimeve për shkak të vendbanimit të përhershëm, vendbanimit të përkohshëm, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose ndonjë kriteri tjetër të kësaj natyre dhe përfshin gjithashtu atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet vendor politik të tij. Ky term, megjithatë, nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimeve në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin që ndodhet në të.

2. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka vendbanimin e përhershëm; nëse ka një vendbanim të përhershëm në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit me të cilin marrëdhëniet e tij personale dhe ekonomike janë më të afërta (qendra e interesave jetësore);

b) nëse shteti ku ka qendrën e interesave të tij jetësore nuk mund të përcaktohet ose nëse ai nuk ka vendbanim të përhershëm në dispozicion në asnjë prej shteteve, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ka vendbanimin e zakonshëm;

c) nëse ka një banesë të zakonshme në të dy shtetet ose në asnjë prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku është shtetas;

d) nëse është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet përgjegjëse të Shteteve Kontraktuese zgjidhin çështjen me marrëveshje reciproke.

3. Kur për arsye të dispozitave të paragrafit 1, një person, përveçse një individ, është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë do të konsiderohet rezident vetëm i shtetit ku ndodhet vendi i tij i menaxhimit efikas.

Neni 5

Filiali i përhershëm

1. Për qëllim të kësaj Konvente, termi “filial i përhershëm” do të thotë një vend i qëndrueshëm biznesi nëpërmjet të cilit drejtohet krejtësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.

2. Termi "filial i përhershëm" përfshin në mënyrë të veçantë:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, gurore ose çdo vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “filial i përhershëm” përfshin gjithashtu:

a) një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi, apo veprimtari mbikëqyrëse në lidhje me to, por vetëm atje ku ky kantier, projekt apo veprimtari vazhdon për një periudhë më shumë se 12 muaj; dhe

b) ofrimin e shërbimeve, përfshirë këtu shërbime konsultimi nga një ndërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose personelit tjetër të përfshirë nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm kur veprimtaritë e kësaj natyre vazhdojnë brenda Shtetit Kontraktues për një periudhë ose periudha që së bashku arrijnë më shumë se 6 muaj në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, duke filluar ose mbaruar me vitin financiar në fjalë.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “filial i përhershëm” do të konsiderohet se nuk përfshin:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes së të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të ruajtjes, paraqitjes ose shpërndarjes;

c) mbajtjen e të mirave ose mallrave që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të blerjes së të mirave ose mallrave ose për mbledhje informacioni, për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për qëllim të vazhdimësisë, për ndërmarrjen, të çdo veprimtarie tjetër të natyrës përgatitore ose plotësuese;

f) mbajtjen e një vendi të qëndrueshëm biznesi vetëm për kombinim të veprimtarive të

përmendura në nënparagrafët “a” deri në “e”, me kusht që veprimtaria në përgjithësi e një vendi të caktuar biznesi që rezulton nga ky kombinim, të ketë natyrë përgatitore ose plotësuese.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, ku një person përveçse një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ku e ushtron zakonisht në një Shtet Kontraktues, autoritetin për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një filial të përhershëm në atë shtet në lidhje me çdo veprimtari që ai person kryen për ndërmarrjen, nëse veprimtaritë e këtij personi nuk kufizohen me ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet vendit të qëndrueshëm të biznesit, nuk do ta bënin këtë vend të qëndrueshëm biznesi një filial të përhershëm sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet se ka filial të përhershëm në një Shtet Kontraktues vetëm sepse kryen biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti të përgjithshëm komisioni ose agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë sipas rrjedhës së zakonshme të biznesit të tyre.

7. Fakti që një kompani, rezidente në një Shtet Kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një kompani që është rezidente në Shtetin tjetër Kontraktues ose që vazhdon biznes në shtetin tjetër (nëpërmjet një sipërmarrjeje të përhershme ose tjetër), asnjë kompani nuk përbën në vetvete një filial të përhershëm të tjetrës.

Neni 6

Të ardhura nga prona e paluajtshme

1. Të ardhurat që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga prona e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Termi “pronë e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet prona në fjalë. Termi në çdo rast përfshin pronë, pjesë të pronës së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisje që përdoren në bujqësi dhe pyje, të drejta për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të përgjithshëm në lidhje me pronën tokësore, uzufruktin e pronës së paluajtshme dhe të drejta për pagesa të ndryshueshme ose të pandryshueshme si shpërblim për funksionimin e, ose të drejtën për të vënë në punë, të depozitave minerare, burimeve dhe burimeve të tjera natyrore; anijet, vaporët dhe avionët nuk konsiderohen pronë e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, lënia në përdorim apo përdorimi në çdo formë tjetër i pronës së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga prona e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga prona e paluajtshme, të përdorura për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Përfitimet e biznesit

1. Përfitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues tatohen vetëm në atë shtet, nëse ndërmarrja nuk vazhdon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje.

Nëse ndërmarrja kryen biznes si më lart, përfitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë që i atribuohet atij filiali të përhershëm.

2. Sipas dispozitave të paragrafit 3, nëse një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, këtij filiali të përhershëm në çdo Shtet Kontraktues do t'i atribuohen përfitimet që mund të pritet të nxjerrë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në veprimtari të njëjta ose të ngjashme sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe nëse merrej tërësisht dhe në mënyrë të pavarur me ndërmarrjen, filiali i së cilës është.

3. Në përcaktimin e përfitimeve të një filiali të përhershëm do të lejohen, si zbritje, shpenzimet (përveç shpenzimeve që nuk do të ishin të zbritshme, nëse ajo sipërmarrje e përhershme do të ishte një ndërmarrje e veçantë e një Shteti Kontraktues) që janë bërë për qëllime të filialit të përhershëm, përfshirë këtu shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative që janë bërë qoftë në shtetin

ku ndodhet filiali i përhershëm, qoftë diku tjetër.

4. Për aq sa është bërë e zakonshme në një Shtet Kontraktues të përcaktojë përfitimet që i atribuohen një filiali të përhershëm në bazë të pjesës së përfitimeve totale të ndërmarrjes me pjesët e saj të ndryshme, asnjë dispozitë në paragrafin 2 nuk do të pengojë Shtetin Kontraktues për të përcaktuar përfitimet që do të taten nga kjo pjesë, siç mund të jetë e zakonshme; metoda e pjesës së miratuar, megjithatë, do të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që përmban ky nen.

5. Asnjë përfitim nuk do t'i atribuohet një filiali të përhershëm për shkak të blerjes nga ky filial i përhershëm i të mirave dhe mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, përfitimet që do t'i atribuohen filialit të përhershëm do të përcaktohen me të njëjtën mënyrë, vit pas viti, nëse nuk ka arsye të mirë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur përfitimet përfshijnë zëra të të ardhurave që trajtohen në mënyrë të veçantë në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e këtyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ndërkombëtar

1. Përfitimet nga operimi i anijeve, avionëve ose automjeteve rrugore në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i menaxhimit efikas të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efikas të një ndërmarrjeje transporti është në bordin e një anijeje, atëherë do të konsiderohet me vendndodhje në Shtetin Kontraktues ku ndodhet limani i anijes, ose nëse nuk ka një liman, në Shtetin Kontraktues ku operatori është rezident.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për përfitimet nga pjesëmarrja në një konsorcium, biznes të përbashkët apo agjenci ndërkombëtare funksionale.

Neni 9

Ndërmarrje e asociuar

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

në secilin rast, kur janë krijuar ose vënë kushtet ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, që dallojnë nga ato që do të ishin krijuar ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo përfitim që do të ishte nxjerrë, përveç atyre kushteve, nga një ndërmarrje, por që për shkak të atyre kushteve, nuk është nxjerrë, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatohet rregullisht.

2. Nëse një Shtet Kontraktues përfshin në përfitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti – dhe taton sipas tyre- përfitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatuar në shtetin tjetër dhe përfitimet e përfshira janë përfitime që do të ishin mbledhur nga ndërmarrja e Shtetit të parë të përmendur, nëse kushtet e vëna ndërmjet dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do t'i ishin vënë ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm për shumën e tatimit të vënë mbi këto përfitime. Në përcaktimin e këtyre rregullimeve, dispozitat e tjera të kësaj Konvente do të shqyrtohen në mënyrë e duhur dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, do të konsultohen me njëra-tjetrën.

3. Dispozitat e paragrafit 2 nuk zbatohen në rastin e mashtrimit, pakujdesisë të rëndë ose mospagimit të vullnetshëm.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët që një kompani rezidente e një Shteti Kontraktues i paguan një rezidenti të

Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto dividendë mund të taten në Shtetin Kontraktues ku kompania që paguan dividendët është rezidente dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i caktuar nuk tejkalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një kompani që mban direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të kompanisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, me marrëveshje reciproke, vendosin mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e kompanisë në lidhje me përfitimet prej të cilave paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë”, sipas përdorimit në këtë nen, do të thotë të ardhura nga aksione të çdo lloji apo të drejta të tjera, që nuk janë pretendime borxhi, të cilat marrin pjesë në përfitime, si edhe të ardhura nga të drejta të kompanisë që i nënshtrohen të njëjtit trajtim i tatimor si të ardhura nga aksionet, sipas ligjeve të shtetit ku kompania që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ka kryer biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, të cilit kompania si rezidente i paguan dividendë nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe sendet pasurore në lidhje me të cilat paguhen dividendët janë të lidhura në mënyrë efikase me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Nëse një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues nxjerr përfitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, shteti tjetër nuk mund të vendosë ndonjë taksë mbi dividendët që paguan kompania, përveçse për sa kohë që këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër, ose për sa kohë që sendet pasurore në lidhje me të cilat janë paguar dividendët, lidhen në mënyrë efikase me një filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme në Shtetin tjetër, as të nënshtrojnë përfitimin e pashpërndarë të kompanisë ndaj një tatimi mbi përfitimin e pashpërndarë të kompanisë, edhe nëse dividendët e paguar ose përfitimi i pashpërndarë përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga përfitimet ose të ardhura që nxirren në shtetin tjetër.

Neni 11

Interesi

1. Interesi që rrjedh në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku rrjedh dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i caktuar nuk kalon 7 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, me marrëveshje reciproke, vendosin mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që rrjedh në Shtetin Kontraktues përjashtohet nga tatimi në atë shtet nëse:

a) paguesi i interesit është qeveria e atij Shteti Kontraktues, ose një nënndarje politike apo autoritet vendor ose bankë qendrore;

b) interesi i paguhet qeverisë, ose një nënndarjeje politike apo autoriteti vendor ose banke qendrore;

c) interesi paguhet në lidhje me një hua të dhënë, të miratuar, të garantuar apo të siguruar nga institucioni, që është autorizuar në përputhje me të drejtën e brendshme për sigurimin dhe financimin e veprimeve ndërkombëtare tregtare.

4. Termi “interes” i përdorur në këtë nen do të thotë të ardhura nga pretendimi i borxhit të çdo lloji, të siguruara apo jo me hipotekë, dhe me të drejtë apo jo për të marrë pjesë në përfitimet e debitorit dhe në veçanti të ardhura nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhura nga bonot ose detyrimet, përfshirë primet dhe çmime që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, bonove apo detyrimeve. Vënia e gjobave për vonesa në pagesa nuk do të konsiderohen si interes për qëllim të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë

rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në një Shtet tjetër Kontraktues ku rrjedh interesi, nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilën paguhet interesi është i lidhur në mënyrë efikase me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme.

Në këtë rast, dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14 zbatohen sipas rastit.

6. Interesi do të konsiderohet se ka rrjedhur në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë ai rezident i një shteti kontraktues apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një sipërmarrje të përhershme ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi mbi të cilin është paguar interesi dhe ky interes ka rrjedhur nga ky filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë ky interes do të konsiderohet se ka rrjedhur në shtetin ku ndodhet filiali i përhershëm ose baza e qëndrueshme.

7. Nëse, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 12

Tarifa për licenca

1. Tarifat për licenca që lindin në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen rezidentit të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa për licenca mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifës për licencë është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk kalon 7% të shumës bruto të tarifës për licencë. Autoritetet përgjegjëse të Shteteve Kontraktuese, me marrëveshje reciproke, vendosin mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “tarifa për licenca” siç përdoret në këtë nen do të thotë pagesa të çdo lloji që merren si një shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit, të të drejtës së autorit për vepra letrare, artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, filmat ose kasetat për transmetim në radio apo televizion, çdo patentë, markë, skicë apo model, plan, formulë sekrete apo proces apo për përdorimin ose për të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifës për licencë, duke qenë rezident në një Shtet Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku lindin tarifën për licencë, nëpërmjet një filiali të përhershëm ndodhet atje ose kryen në Shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen tarifën për licencë lidhet në mënyrë efikase me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14.

5. Tarifat për licencë do të konsiderohen që kanë lindur në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifën për licencë, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në Shtetin Kontraktues një filial të përhershëm ose një bazë të qëndrueshme në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi për të paguar tarifën për licencë dhe kjo tarifë për licencë ka lindur nga kjo filial i përhershëm ose bazë e qëndrueshme, atëherë këto tarifa për licencë do të konsiderohen se kanë lindur në shtetin ku ndodhet sipërmarrja e përhershme ose baza e caktuar.

6. Nëse për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues, ose ndërmjet të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e tarifave për licencë, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin janë paguar, tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur të fundit.

Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të çdo Shteti Kontraktues, duke marrë parasysh si duhet dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

Neni 13
Fitimet kapitale

1. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i pronës së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Fitimet që një rezident i një Shteti Kontraktues përfton nga tjetërsimi i aksioneve ose nga një interes i krahasueshëm i çdo lloji duke nxjerrë më shumë se 50% të vlerës së tyre direkt apo indirekt nga prona e paluajtshme që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pronës së luajtshme që janë pjesë e pronës së biznesit të një filiali të përhershëm që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të një prone të luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues, për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, përfshirë këtu fitimet nga tjetërsimi i këtij filiali të përhershëm (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose i kësaj baze të qëndrueshme, mund të tatohen në shtetin tjetër.

4. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve, avionëve ose automjeteve rrugore që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pronës së luajtshme që i përket veprimtarisë së këtyre anijeve, avionëve ose automjeteve rrugore, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i menaxhimit efikas të ndërmarrjes.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër, përveç atyre të përmendura në paragrafët 1, 2, 3, dhe 4, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku tjetërsuesi është rezident.

Neni 14
Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat që përfitohen nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbime profesionale ose të tjera të ngjashme të natyrës së pavarur, do të tatohen vetëm në atë shtet, përveçse në rrethanat e mëposhtme, kur këto të ardhura mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë të qëndrueshme që është rregullisht në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer veprimtarinë e tij; në këtë rast, vetëm pjesa e të ardhurave që i atribuohen asaj baze të qëndrueshme mund të tatohet në shtetin tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që arrijnë ose kalojnë në total 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin kalendarik në fjalë; në këtë rast, vetëm pjesa e të ardhurave që rrjedhin nga veprimtaritë e tij të kryera në atë Shtet mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht veprimtari të pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative apo mësimdhënie, si dhe veprimtari të pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, audituesve dhe llogaritarëve.

Neni 15
Shërbime personale të varura

1. Sipas dispozitave të neneve 16, 17, 19 dhe 20, pagat, rrogat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që rrjedhin nga një rezident i një Shteti Kontraktues për një punësim do të tatohen vetëm në atë Shtet, përveçse kur punësimi nuk është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet kështu, ky shpërblim që rrjedh prej tij mund të tatohet në Shtetin tjetër.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi që përfton një rezident i një Shteti Kontraktues për punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të tatohet vetëm në shtetin e përmendur më parë nëse:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë që nuk i kalon në total 183 ditë të çdo periudhe 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin financiar në fjalë; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident në shtetin tjetër, dhe

c) shpërblimi nuk lind nga një filial i përhershëm ose një bazë e qëndrueshme që ka punëdhënësi në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi që rrjedh për punësimin e ushtruar në bordin e një anijeje, avioni apo automjeti rrugor që vepron në trafikun ndërkombëtar, mund të tatohet në Shtetin Kontraktues ku ndodhet menaxhimi efikas i ndërmarrjes.

Neni 16

Tarifat e drejtorëve

Tarifat e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose të një organi të ngjashëm të një kompanie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht dispozitave të nenit 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident në një Shtet Kontraktues si një argëtues, artist teatri, filmi, radioje apo televizioni, ose muzikant apo sportist në veprimtarinë e tij personale të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

2. Nëse të ardhurat në lidhje me veprimtaritë personale të ushtruara nga një argëtues apo sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk mblidhen për argëtuesin apo sportistin por për një person tjetër, këto të ardhura mund të tatohen, pavarësisht dispozitave të neneve 7, 14 dhe 15, në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti ushtron veprimtarinë e tij.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që përftohen nga një argëtues ose sportist prej veprimtarive të ushtruara në një Shtet Kontraktues, nëse vizita në atë Shtet mbështetet plotësisht ose pjesërisht nga fondet publike të Shtetit tjetër Kontraktues ose të një nënndarjeje politike apo autoriteti vendor. Në këtë rast, të ardhurat tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku argëtuesi apo sportisti është rezident.

Neni 18

Pensionet

Sipas dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues për punësimin në të kaluarën, do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat, rrogat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, përveç një pensioni që një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike apo autoritet vendor i paguan një individ në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo asaj nënndarjeje ose autoriteti, do të tatohen vetëm në atë shtet;

b) Megjithatë, këto paga, rroga dhe shpërblime të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë bërë në atë shtet dhe individi është rezident i atij shteti:

i) ku është shtetas; ose

ii) ku nuk është bërë rezident i atij shteti për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike apo autoritet vendor për një individ në lidhje me shërbimet që i janë bërë atij shteti apo asaj nënndarjeje ose autoriteti, do të tatohen vetëm në atë shtet;

b) Megjithatë, ky pension do të tatohet vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individi është rezident ose shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17, dhe 18 zbatohen për pagat, rrogat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme dhe për pensionet, në lidhje me shërbimet që janë kryer për një biznes të drejtuar nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike apo autoritet vendor.

Neni 20
Profesorët dhe studiuesit

1. Një rezident i Shtetit Kontraktues që, me ftesë të një universiteti, kolegji, shkolle apo institucioni tjetër të ngjashëm që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues dhe që njihet nga qeveria e Shtetit tjetër Kontraktues, është përkohësisht i pranishëm në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për qëllime studimi apo kërkimi, ose të dyja, në institucionin arsimor, për një periudhë që nuk kalon dy vjet nga data e mbërritjes së tij në Shtetin tjetër Kontraktues, do të përjashtohet nga tatimet për shpërblimin për këtë studim apo kërkim në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Sipas paragrafit 1 nuk do të bëhet asnjë përjashtim në lidhje me shpërblimin për kërkim, nëse ky kërkim nuk ndërmerret për interes publik, por për përfitim privat të një personi apo disa personave të caktuar.

Neni 21
Studentët

1. Pagesat që merr për jetesë, edukim apo trajnim një student ose stazhier, i cili është ose ishte rezident i Shtetit tjetër Kontraktues para se të vizitonte një Shtet Kontraktues dhe i cili është i pranishëm në shtetin e parë të përmendur vetëm për qëllime arsimimi apo trajnimi, nuk do të tatohen në atë shtet, me kusht që kjo pagesë të lindë nga burimet jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me grantet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi që nuk përfshihen në paragrafin 1, një student apo stazhier, i përmendur në paragrafin 1, do të ketë të drejtën, gjithashtu, gjatë këtij edukimi apo trajnimi për të njëjtin përjashtim, lehtësim apo reduktim për tatimet që u vihen rezidentëve të Shtetit Kontraktues që ai viziton.

Neni 22
Të ardhura të tjera

1. Zëra të të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kurdo që lindin, që nuk janë trajtuar në nenet e mësipërme të kësaj Konvente, do të tatohen vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhura, përveç të ardhurave nga prona e paluajtshme siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, kryen biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një filiali të përhershëm që ndodhet atje, ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë e qëndrueshme që ndodhet atje, dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilën paguhet të ardhurat, lidhet në mënyrë efikase me këtë filial të përhershëm ose bazë të qëndrueshme. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose të nenit 14.

Neni 23
Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga prona e paluajtshme, e përmendur në nenin 6, që zotërohet nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga prona e luajtshme që bën pjesë në pronën e biznesit të një filiali të përhershëm që një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga prona e luajtshme që i përket një baze të qëndrueshme në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, mund të tatohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet, avionët apo automjetet rrugore që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga prona e luajtshme që i përket funksionimit të këtyre anijeve, avioni apo automjeteve rrugore, do të tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i menaxhimit efikas të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë

shtet.

Neni 24

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet si më poshtë:

1. Në Shqipëri:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura ose zotëron kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohet në Slloveni, Shqipëria do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Slloveni;

ii) si zbritje nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Slloveni.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatohet në Slloveni.

b) Nëse në përputhje me çdo dispozitë të Konventës, të ardhurat e përftuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimet në Shqipëri, pavarësisht nga kjo, Shqipëria, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat apo kapitalin që mbetet për këtë rezident, merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Në Slloveni:

Nëse një rezident i Sllovenisë përfton të ardhura ose zotëron kapital i cili në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohet në Shqipëri, Sllovenia do të lejojë:

i) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri;

ii) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri.

Megjithatë, kjo zbritje, në secilin rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin, të llogaritur përpara se të bëhet zbritja, e cila sipas rastit bëhet për të ardhurat ose kapitalin që mund të tatohet në Shqipëri.

b) Nëse në përputhje me çdo dispozitë të Konventës, të ardhurat e përftuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Sllovenisë përjashtohet nga tatimi në Slloveni, pavarësisht nga kjo, Sllovenia, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat apo kapitalin që mbetet për këtë rezident, merr parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 25

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues asnjë tatimi apo kërkesë që lidhet me të, që është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilat u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet gjithashtu për personat që nuk janë rezidentë të njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen në asnjë Shtet Kontraktues tatimit apo kërkesës në lidhje me të, që është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e shtetit tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën.

3. Tatimi mbi një filial të përhershëm që ka një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të mblidhet në Shtetin tjetër me më pak favorizim sesa tatimi që mblidhet nga ndërmarrjet e shtetit tjetër që kryejnë të njëjtat veprimtari. Kjo dispozitë nuk do të shpjegohet si detyrim për Shtetin Kontraktues që t'u japë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihmë personale, lehtësime dhe reduktime për qëllime tatimore në emër të gjendjes civile apo përgjegjësive familjare që u jep rezidentëve të tij.

4. Përveçse kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1, neni 9; paragrafit 7, neni 11 apo paragrafit 6, neni 12; interesat, tarifat për licencë dhe disbursime të tjera që i paguhen një rezidenti të Shtetit

tjetër Kontraktues nga një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues, me qëllim që të përcaktohen fitimet e tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të reduktohen me të njëjtat kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur. Po ashtu, çdo detyrim i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues për një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim që të përcaktohet kapitali i tatueshëm i kësaj ndërmarrjeje, do të reduktohet sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të parë të përmendur.

5. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave kontrollohet tërësisht apo pjesërisht, direkt apo indirekt nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohen në shtetin e parë të përmendur tatimit apo kërkesës tjetër të lidhur me të që është tjetër ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat në lidhje me të, të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të ngjashme të Shtetit të parë të përmendur.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 26

Procedura e marrëveshjes reciproke

1. Nëse një person çmon që veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për atë në tatim që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, ai, pavarësisht nga mjetet e parashikuara në të drejtën e brendshme të atyre shteteve, mund të paraqesë çështjen e tij tek autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues ku është rezident, ose, nëse çështja e tij është sipas paragrafit 1 të nenit 25, tek Shteti Kontraktues ku ai është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre viteve nga njoftimi i parë i veprimit që ka rezultuar në vendosjen e tatimit që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent do të përpiqet, nëse kundërshtimi duket i justifikuar, dhe nëse nuk është e mundur të arrihet një zgjidhje e kënaqshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e përfunduar do të zbatohet në të drejtën e brendshme të Shteteve Kontraktuese, pavarësisht nga afatet kohore.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të ndërsjellë vështirësitë apo dyshimet që lindin për interpretimin ose shpjegimin e Konventës. Ato gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk parashikohen në Konventë.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund t'i komunikojnë njëri-tjetrit direkt qëllimet për arritjen e një marrëveshjeje sipas kuptimit të paragrafëve të mësipërm.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente apo ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi që vihen në emër të Shteteve Kontraktuese, ose të nënndarjeve politike apo autoriteteve vendore, për sa kohë që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1 dhe 2. Çdo informacion që merret nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti dhe do t'i jepet vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen, ose përcaktimin e ankesave në lidhje me tatimet e përmendura në fjalinë e parë. Këto persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund të japin këtë informacion në procedime gjyqësore publike ose në vendime gjyqësore.

2. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në mënyrë që të vendosë në një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) për të marrë masa administrative në përputhje me ligjet dhe praktikat administrative të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) për të siguruar informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose në rrugën normale të

administratës të atij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) për të siguruar informacion që do të zbulonte ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, apo profesional apo proces tregtie, ose informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikat publike (rend publik).

Neni 28

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullores së përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet rrugëve diplomatike, që janë plotësuar procedurat e nevojshme nga legjislacioni përkatës për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente. Kjo Konventë hyn në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Konventë zbatohet:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen në 1 janar ose pas 1 janarit të vitit kalendarik të vitit pasardhës, kur ka hyrë në fuqi konventa;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, kapitalin, për tatimet e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari dhe pas tij të vitit pasardhës kalendarik, pas vitit të hyrjes në fuqi të Konventës.

Për qëllimet e nenit 27 (shkëmbimi i informacionit), dispozitat hyjnë në fuqi datën e hyrjes në fuqi ose pas saj të kësaj Konvente.

Neni 30

Prishja

1. Kjo Konventë mbetet në fuqi derisa të prishet nga një Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të prishë Konventën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, duke bërë një njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik, pas periudhës pesë vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Në këtë rast, Konventa nuk do të ketë më fuqi:

a) në lidhje me tatimet që mbahen në burim, për të ardhurat që përftohen më 1 janar ose pas 1 janarit të vitit të ardhshëm kalendarik, pas vitit kur është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatime të tjera mbi të ardhurat, taksat mbi kapitalin, taksat e vendosura për çdo vit tatimor duke filluar nga 1 janari dhe pas tij të vitit pasardhës kalendarik, pas vitit kur është dhënë njoftimi.

Me praninë e tyre, të nënshkruarit, me autoritet të plotë për këtë, nënshkruan këtë Konventë.

Nënshkruar në dublikatë në Tiranë më 27 shkurt 2008, në sllovenisht, shqip dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje ndërmjet ndonjërit prej teksteve, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

LIGJ

Nr.9939, datë 26.6.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN E PJESSHME, TË ZGJERUAR, NË SPORT (EPAS)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen e pjesshme, të zgjeruar, në sport (EPAS)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5802, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

REZOLUTË CM/RES (2007)8

THEMELUESE E MARRËVESHJES SË PJESHME TË ZGJERUAR MBI SPORTIN (EPAS)

(MIRATUAR NGA KOMITETI I MINISTRAVE MË 11 MAJ 2007

NË SESIONIN E TIJ TË 117-TË)

Përfaqësuesit në Komitetin e Ministrave të Andorrës, Azerbajxhanit, Bosnjës dhe Hercegovinës, Qipros, Danimarkës, Francës, Hungarisë, Islandës, Letonisë, Luksemburgut, Holandës, Norvegjisë, San Marinos, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Mbretërisë së Bashkuar,

- *duke njohur* që qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij për qëllimin e garantimit dhe realizimit të ideve dhe parimeve që janë trashëgimi e përbashkët dhe lehtësimit të përparimit të tyre ekonomik dhe social, veçanërisht duke ndjekur objektiva të përbashkët të destinuara për të mbrojtur dhe nxitur kulturën europiane;

- *duke pasur parasysh* Rezolutën statutore (93) 28 të Komitetit të Ministrave mbi marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara;

- *duke pasur parasysh* Rezolutën (96) 36 të Komitetit të Ministrave që cakton kriteret për marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara të Këshillit të Europës;

- *duke pasur parasysh* rezolutat e miratuara nga konferencat e ministrave europianë përgjegjës për sportin që nga 1975 dhe veçanërisht rezolutën nr.1 mbi bashkëpunimin e ardhshëm pan-europian për sportet, të miratuar në mbledhjen e 17-të informale të ministrave europianë për sportet (Moskë, 20-21 tetor 2006);

- *duke pasur parasysh* punën thelbësore të bërë që nga 1977 nga Komiteti i Zhvillimit të Sportit (CDDS) për zhvillimin e politikave të projektuara për të nxitur sportin në shtetet anëtare të Këshillit të Europës;

- *duke pasur parasysh* Konventën kulturore europiane të datës 19 dhjetor 1954 (ETS nr.018);

- *duke pasur parasysh* Konventën europiane mbi dhunën e spektatorit dhe sjelljen jo të hijshme në ngjarje sportive dhe veçanërisht në ndeshjet e futbollit (ETS nr.120), konventën kundër përdorimit të substancave narkotike (ETS nr.135) dhe protokollin e saj shtesë (ETS nr.188);

- *duke pasur parasysh* rekomandimet e Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Kartën e rishikuar europiane për sportet (Rekomandim R (92) 13 rev) dhe Kodin e Rishikuar të Etikës në Sporte (Rekomandim R (92) 14 rev);

- *duke pasur parasysh* konkluzionet e samitit të tretë të kryetarëve të shteteve dhe qeverive të Këshillit të Europës (Varshavë, 16-17 maj 2005) që rekomanduan vazhdimin e aktiviteteve të Këshillit të Europës që shërbejnë si referenca në fushën e sportit;

- *duke pasur parasysh* që vlerat natyrore të sporteve, si: respekti, mirëkuptimi reciprok dhe loja e drejtë janë mjete të shkëlqyera për nxitjen e vlerave dhe qëllimeve të Këshillit të Europës;

- *të ndërgjegjshëm* për vendin unik që ka sporti në shoqërinë moderne në mbështetje të demokracisë, pjesëmarrja, përfshirja, motivimi, përfshirja dhe kohezioni social;

- *duke theksuar* rëndësinë dhe domethënien e sportit në shoqërinë moderne, kryesisht nga këndvështrimi politik, social, kulturor dhe ekonomik;

- *të ndërgjegjshëm* për rolin e sportit për integrimin social, veçanërisht ndërmjet të rinjve, dhe në garantimin e shëndetit të popullatës;

- *duke pasur parasysh* vendimin e 9 majit 2007, nëpërmjet të cilit Komiteti i Ministrave

autorizonte shtetet anëtare që dëshirojnë të ndjekin këtë objektiv brenda Këshillit të Europës nëpërmjet një marrëveshjeje të pjesshme të zgjeruar;

këtu,

- vendosin të themelojnë Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar mbi sportin (EPAS), të rregulluar nga statuti i bashkëngjitur;

- bien dakord që EPAS të themelohet për një periudhë fillestare prej tre vjetësh;

- bien dakord të rishikojnë funksionimin e EPAS, me qëllim vazhdimin e funksionimit të saj, rreth fundit të periudhës fillestare prej tre vjetësh;

- shprehin dëshirën që të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe Shtetet e tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane bëhen anëtare të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar mbi sportet (EPAS) në të ardhmen e afërt.

Këshilli i Europës
Strasburg

18 korrik 2007
EPAS (2007) INF2 BIL

STATUTI I MARRËVESHJES SË PJESSHME TË ZGJERUAR MBI SPORTET (EPAS) (siç është miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 maj 2007), në sesionin e tij të 117-të)

Neni 1 Detyrat

1.1 EPAS përmbush detyrat e mëposhtme:

Bërja e politikave dhe caktimi i standardeve

- Zhvillon strategji politike për sportin dhe cakton standarde të përshtatshme, duke reflektuar rëndësinë e sportit në shoqërinë moderne, në bashkëpunim dhe dialog me të gjitha palët e interesuara.

- Stimulon dhe siguron bashkërendimin e politikave dhe standardeve të sporteve brenda dhe ndërmjet Shteteve Palë, kryesisht me qëllim për ta bërë praktikën e sigurt të sportit e tij sa më të përhapur që të jetë e mundur.

- Propozon politikat e nevojshme për të trajtuar çështjet kryesore në sportin ndërkombëtar.

- Nxit zhvillimin e sporteve, si një mjet për të nxitur mënyrën e shëndetshme të jetesës.

Monitorimi

- Monitoron zbatimin e Kartës Europiane për Sportet (Rekomandimi nr. R (92) 13 rev) dhe të Kodit të Etikës së Sporteve (Rekomandimi nr. R (92) 14 rev) në shtetet anëtare të Marrëveshjes.

Ndërtimi i kapaciteteve

- Ndjekja e veprimeve për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e “sporteve për të gjithë”.

Programi i aktiviteteve

- Zbaton aktivitete ndërqeveritare të bashkëpunimit në sporte sipas vendimeve të bordit qeverisës.

Takimet ministeriale

- Përgatit takimet në nivel ministerial, të hapur për anëtarët e EPAS dhe të gjitha Shteteve të tjera Palë në Konventën Kulturore Europiane, në intervale të rregullta dhe siguron punën e përshtatshme vazhduese për to.

1.2 Për këtë qëllim, ai, veçanërisht:

- bashkëpunon, sipas rastit, në këto çështje me Komitetin e Përhershëm të Konventës europiane mbi dhunën e spektatorit dhe sjelljen e pahijshme në ngjarjet sportive dhe veçanërisht në ndeshjet e futbollit (T-RV), Grupin e Monitorimit të Konventës kundër përdorimit të substancave narkotike (T-DO), dhe me Komitetin Ad-Hoc Forumin e Bashkërendimit Europian për Agjencinë Botërore kundër Përdorimit të Substancave Narkotike (CAHAMA), dhe veçanërisht shqyrton përfshirjen e punës në lidhje me zhvillimin e secilës konventë në programin e vet të aktiviteteve;

- bashkërendon punën e tij me atë të sektorëve të tjerë të Këshillit të Europës dhe kontribuon në iniciativat multisektoriale dhe programe të tjera të përbashkëta të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm;

- zhvillon bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, rajonale, kombëtare ose jo qeveritare

dhe strukturat kundër përdorimit të substancave narkotike.

Neni 2

Aderimi dhe anëtarësia

2.1 Çdo shtet që është një anëtar i Këshillit të Europës ose një Palë Kontraktuese në Konventën Kulturore Europiane mund të bashkohet me Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2.2 Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij, të kufizuar me përfaqësuesit e shteteve anëtare të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar, nëpërmjet shumicës së parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës, mund të ftojë çdo shtet tjetër joanëtar të Këshillit të Europës për t'u futur në Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar, pas konsultimit me shtetet joanëtare që tashmë marrin pjesë. Një shtet joanëtar që merr një iniciativë të tillë njofton Sekretarin e Përgjithshëm në lidhje me synimin e tij për t'u bërë anëtar i EPAS.

2.3 Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe palët e tjera në Konventën kulturore europiane që nuk futen në Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar mbi sportin mund të kërkojnë statusin e vëzhguesit tek EPAS. Vendimet në këto çështje do të merren nga bordi qeverisës i EPAS.

2.4 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës mund të marrin pjesë në punën e EPAS pa të drejtë vote.

2.5 Komuniteti European ka të drejtë të marrë pjesë në punën e EPAS pa të drejtë vote. Ai mund të bëhet anëtar i EPAS në pajtim me modalitetet e rëna dakord me Komitetin e Ministrave.

2.6 Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij të kufizuar me përfaqësuesit e shteteve anëtare të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar, me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës, mund të autorizojë EPAS-in të ftojë organizata ndërkombëtare, OJQ ose organe të tjera të marrin pjesë në punën e tij si vëzhgues pa të drejtë vote.

Neni 3

Bordi qeverisës

3.1 Bordi qeverisës i EPAS përbëhet nga një anëtar i emëruar nga qeveria e secilit anëtar të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar. Organizata Europiane Joqeveritare për Sportet (ENGSO) përfaqësohet në bordin qeverisës pa të drejtë vote.

3.2 Bordi qeverisës zgjedh nga anëtarët e tij një byro që përbëhet nga një kryetar, një zëvendëskryetar, katër anëtarë dhe një përfaqësues i Organizatës Europiane Joqeveritare (ENGSO) pa të drejtë vote, për një mandat prej dy vjetësh, të rinovuar vetëm një herë.

3.3 Bordi qeverisës:

- është përgjegjës për zbatimin e përgjithshëm të detyrave që i caktohen EPAS;
- miraton projektprogramet vjetore të aktiviteteve të EPAS dhe i paraqet, në pajtim me rregulloret financiare të Këshillit të Europës, propozime Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në lidhje me hartimin e projektbuxhetit vjetor, para kalimit të tij te Komiteti Statutor i ngritur në pajtim me nenin 5 të mëposhtëm:

- vendos në lidhje me projektet pilot në pajtim me prioritetet politike të Këshillit të Europës, dhe harton buxhetet përkatëse;

- monitoron zbatimin e programit të aktiviteteve dhe menaxhimin e fondeve të EPAS;

- miraton dhe transmeton një raport vjetor të aktiviteteve për Komitetin e Ministrave.

3.4 Bordi qeverisës takohet një herë në vit të Këshilli i Europës. Ai mund të ftojë përfaqësues të organeve përkatëse të Këshillit të Europës për të marrë pjesë në takime, pa të drejtë vote, në pajtim me temat e rendit të ditës.

3.5 Bordi qeverisës mund t'i caktojë detyra operationale byrosë. Byroja mbledhet nga kryetari i bordit qeverisës të paktën një herë në vit.

3.6 Bordi qeverisës i miraton vendimet e tij me një shumicë prej dy të tretat e votave të hedhura, ku çdo anëtar ka një votë. Çështjet procedurale zgjidhen me shumicën e votave të hedhura. Për çështjet e tjera, bordi qeverisës miraton rregullat e veta të procedurës dhe çdo masë tjetër për zbatimin e aktiviteteve.

3.7 Themelohet një komitet konsultativ mbi programin e aktiviteteve të EPAS, që përbëhet

nga anëtarë të organizatave ndërkombëtare, OJQ ose organe që marrin pjesë në punën e Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar në pajtim me dispozitat e nenit 2.6. Komiteti konsultativ, si një organ partneriteti jep një mendim mbi programin e aktiviteteve dhe jep këshillë për vendimet e bordit qeverisës. Bordi qeverisës emëron komitetin konsultativ dhe cakton mandatin e tij.

Neni 4

Buxheti

4.1 Burimet e EPAS përbëhen nga:

- kontributet vjetore nga secili anëtar që futet në EPASD;
- çdo pagesë tjetër, dhurim ose donacion, në pajtim me dispozitat e paragrafit 4.3 më poshtë.

4.2 Shpenzimet në lidhje me zbatimin e programit të aktiviteteve dhe shpenzimet e zakonshme të sekretariatit mbulohen nga një buxhet i një marrëveshjeje të pjesshme të financuar nga shtetet anëtare dhe shtetet joanëtare që marrin pjesë në Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar.

4.3 EPAS mund të marrë gjithashtu kontribute vullnetare dhe të tjera në lidhje me punën e marrëveshjes, në pajtim me autorizimin e bordit qeverisës para pranimit të tyre. Në rrethana të veçanta, Sekretari i Përgjithshëm mund të konsultohet me komitetin statutor para pranimit të një kontributi vullnetar. Këto kontribute paguhen në një llogari të veçantë, të hapur sipas termave të nenit 4.2 të rregulloreve financiare të Këshillit të Europës, të monitoruar nga bordi qeverisës në konsultim me komitetin konsultativ dhe përcaktohen për objektivat dhe detyrat e caktuara, me kusht që ato të jenë në pajtim me qëllimet e statutit.

4.4 Burimet financiare të EPAS përfitojnë nga dispozitat e Marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet e Këshillit të Europës.

4.5 Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të personave që ndjekin mbledhjet e bordit qeverisës, të komitetit konsultativ dhe, sipas rastit, të komitetit statutor mbulohen nga shteti ose organizata e interesuar.

4.6 Rregulloret financiare të Këshillit të Europës zbatohen *muttis mutandis* për miratimin dhe menaxhimin e buxhetit të EPAS.

Neni 5

Komiteti statutor

5.1 Komiteti statutor përbëhet nga përfaqësuesit e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Europës që marrin pjesë në EPAS dhe nga përfaqësuesit e caktuar veçanërisht për këtë qëllim nga shtetet joanëtare që marrin pjesë në EPAS.

5.2 Komiteti statutor përcakton çdo vit totalin e kontributit të detyrueshëm të anëtarëve për EPAS-in dhe shkallën e kontributeve, në pajtim me të cilën totali do të ndahet ndërmjet shteteve pjesëmarrëse; si rregull i përgjithshëm, kjo shkallë përputhet me kriteret për përcaktimin e shkallës së kontributeve për buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Europës.

5.3 Komiteti statutor miraton çdo vit buxhetin e EPAS për shpenzimet në lidhje me zbatimin e programit të aktiviteteve dhe shpenzimet e përgjithshme të sekretariatit.

5.4 Komiteti statutor miraton çdo vit llogaritë vjetore të EPAS, që përpilohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës në pajtim me rregulloret financiare të Këshillit të Europës dhe të paraqitura në komitetin statutor të shoqëruar nga raporti i auditit të jashtëm, sipas parashikimit në rregulloret financiare. Për ta liruar Sekretarin e Përgjithshëm nga përgjegjësia për menaxhimin e vitit financiar në fjalë, komiteti statutor i transmeton Komitetit të Ministrave llogaritë vjetore, së bashku me aprovimin e tij ose komentet dhe raportin e hartuar nga auditit i jashtëm, sipas parashikimit në rregulloret financiare.

Neni 6

Sekretariati

6.1 Sekretariati i Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar, i kryesuar nga sekretari ekzekutiv, sigurohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

6.2 Sekretari ekzekutiv mund t'u drejtohet institucioneve ose ekspertëve të pavarur në sferat e prekura nga programi.

6.3 EPAS vendoset në selinë e Këshillit të Europës.

Neni 7
Amendimet

Komiteti i Ministrave, në përbërjen e tij të kufizuar me përfaqësuesit e shteteve anëtare të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar, dhe pas konsultimeve me anëtarët e tjerë të përcaktuar në nenin 2, mund të miratojë amendime në këtë statut nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të statutit të Këshillit të Europës.

Neni 8
Tërheqja

8.1 Çdo anëtar mund të tërhiqet nga EPAS nëpërmjet një deklarate dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

8.2 Sekretari i Përgjithshëm konfirmon marrjen e deklaratës dhe informon anëtarët e EPAS-it.

8.3 Për analogji në nenin 7 të statutit të Këshillit të Europës, tërheqja hyn në fuqi:

- në fund të vitit financiar në të cilin ai njoftohet, nëse ky njoftim jepet gjatë nëntë muajve të parë të atij viti financiar;

- në fund të vitit pasues financiar, nëse njoftimi për tërheqjen jepet në tre muajt e fundit të vitit financiar.

8.4 Në pajtim me nenin 18 të rregulloreve financiare të Këshillit të Europës, bordi qeverisës shqyrton pasojat financiare të tërheqjes së një anëtarit dhe merr masat e përshtatshme.

8.5 Sekretari i Përgjithshëm njofton menjëherë anëtarin e interesuar për pasojat e tij të tërheqjes.

LIGJ
Nr.9940, datë 26.6.2008

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN EUROPIANE
PËR ZBATIMIN E NENIT 23 TË KONVENTËS SË VITIT 1949 PËR TRAFIKUN RRUGOR,
NË LIDHJE ME PËRMASAT DHE PESHËN E MJETEVE, QË LEJOHEN TË UDHËTOJNË
NË RRUGË TË ÇAKTUARA TË PALËVE KONTRAKTUESE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen europiane për zbatimin e nenit 23 të konventës së vitit 1949 për trafikun rrugor, në lidhje me përmasat dhe peshën e mjeteve, që lejohen të udhëtojnë në rrugë të caktuara të palëve kontraktuese”, nënshkruar në Gjenevë më 16 shtator 1950.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5803, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

E/ECE/TRANSP/229
E/ECE/TRANSP/SCI/91
18 SHTATOR 1950

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT TOKËSOR
NËNKOMITETI I TRANSPORTIT RRUGOR

MARRËVESHJA EUROPIANE

PËR ZBATIMIN E NENIT 23 TË KONVENTËS SË VITIT 1949 MBI TRAFIKUN RRUGOR, NË LIDHJE ME DIMENSIONET DHE PESHAT E MJETEVE QË LEJOHEN TË UDHËTOJNË NË RRUGË TË CAKTUARA TË PALËVE KONTRAKTUESE
NËNSHKRUAR NË GJENEVË MË 16 SHTATOR 1950

Palët Kontraktuese,
të mbledhura nën kujdesin e Komisionit Ekonomik për Europën në Gjenevë;
duke kërkuar të zhvillojnë dhe intensifikojnë, në shkallën më të lartë të mundshme, në përputhje me kërkesën për siguri rrugore, trafikun e mjeteve në rrugë, përdorimi i të cilave shtrihet brenda juridiksionit të tyre;

duke marrë parasysh që neni 23 i Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor ofron përfundimin e marrëveshjeve rajonale, që përcaktojnë zyrtarisht rrugë të veçanta të Palëve Kontraktuese, në të cilat lejohen të udhëtojnë mjete me dimensione dhe peshë jo më të madhe se ato të paraqitura në aneksin 7 të kësaj Konvente,

kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

Neni 1

Rrugët e përcaktuara zyrtarisht nga Palët Kontraktuese në aneksin e kësaj Marrëveshjeje do të jenë të hapura për mjetet, dimensionet dhe peshat maksimale të lejueshme të të cilëve, me ose pa ngarkesë, me kusht që asnjë mjet nuk do të mbajë një ngarkesë maksimale më të madhe nga ajo që është deklaruar e lejueshme nga autoriteti përgjegjës i vendit në të cilin është regjistruar, nuk i kalojnë dimensionet dhe peshat e paraqitura në aneksin 7 të Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor.

Neni 2

1. Çdo Palë Kontraktuese në çdo kohë, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se, që nga data e njoftimit të sipërpërmendur, kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet më për një periudhë të caktuar, ose të pacaktuar, për një rrugë të veçantë të caktuar zyrtarisht në aneksin e këtij dokumenti.

2. Çdo Palë Kontraktuese në çdo kohë, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se, që nga data e njoftimit të sipërpërmendur, ajo do të përcaktojë zyrtarisht një rrugë tjetër nga ato të përcaktuara zyrtarisht në aneksin e këtij dokumenti, në të cilën do të lejohen të udhëtojnë mjetet me dimensione dhe pesha maksimale të lejueshme, me ose pa ngarkesë, nuk i kalojnë dimensionet dhe peshat maksimale të paraqitura në aneksin 7 të Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t'i kujtojë Palët e tjera Kontraktuese në lidhje me njoftimet e sipërpërmendura.

Neni 3

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 30 qershor 1951 dhe, pas kësaj date, për aderim nga vendet që marrin pjesë në punimet e Komitetit Ekonomik për Europën.

2. Instrumenti i aderimit dhe, nëse kërkohet, i ratifikimit do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të njoftojë të gjitha vendet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni për marrjen e njoftimit në fjalë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet me anë të një lajmërimi zyrtar gjashtëmuajor të dorëzuar te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do të njoftojë Palët e tjera Kontraktuese për

lajmërimin në fjalë. Pas skadimit të periudhës gjashtëmujore, Marrëveshja nuk do të ketë më fuqi ligjore për Palën Kontraktuese që e ka denoncuar atë.

Neni 5

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur tre nga vendet e referuara në nenin 3 paragrafi 1 do të jenë bërë Palë Kontraktuese.

2. Ajo nuk do të ketë më fuqi ligjore nëse në çdo kohë numri i Palëve Kontraktuese në të është më pak se tre.

Neni 6

Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilën Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin me negociata ose mënyrë tjetër zgjidhjeje, mund të drejtohen për vendim, me kërkesë të njërës prej Palëve Kontraktuese të interesuara, te një komision arbitrazhi, në të cilin secila nga Palët Kontraktuese të interesuara do të caktojë një anëtar, kurse kryetari i tij do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

1. Origjinali i kësaj Marrëveshjeje do t'i depozitohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë një kopje të certifikuar të këtij dokumenti te secili nga vendet e referuara në nenin 3 paragrafi 1.

2. Sekretari i Përgjithshëm është i autorizuar ta regjistrojë këtë Marrëveshje me hyrjen e saj në fuqi.

Në dëshmi sa më sipër, përfaqësuesit e nënshkruar, pas komunikimit të fuqive të plota të tyre, gjetur në formë të mirë dhe të përshtatshme, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Gjenevë, në një kopje të vetme, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet njëlloj autentike, më gjashtëmbëdhjetë shtator njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë.

SHQIPËRI

AUSTRI

BELGIKË

BULLGARI

REPUBLIKA SOCIALISTE SOVJETIKE

E BJELLORUSISË

ÇEKI

DANIMARKË

EGJIPT

FINLANDË

FRANCË

GREQI

HUNGARI

ISLANDË

IRAK

IRLANDË

IZRAEL

ITALI

MBRETËRIA HASHEMITE E JORDANISË

LIBAN

LUKSEMBURG

HOLANDË

I nënshtrohet ratifikimit

NORVEGJI

POLONI

PORTUGALI
 RUMANI
 SUEDI
 ZVICËR
 SIRI
 TURQI
 REPUBLIKA SOCIALISTE SOVJETIKE E
 UKRAINËS
 BASHKIMI I REPUBLIKAVE SOCIALISTE
 SOVJETIKE
 MBRETËRIA E BASHKUAR
 JUGOSLLAVI

ANEKS

RRUGËT E HAPURA PËR AUTOMJETET, DIMENSIONET DHE PESHAT MAKSIMALE TË TË CILAVE NUK I KALOJNË ATO TË PARAQITURA NË ANEKSIN 7 TË KONVENTËS SË VITIT 1949 MBI TRAFIKUN RRUGOR

Listat e rrugëve të Palëve Kontraktuese që nuk paraqiten në aneksin bashkëlidhur, do të komunikohen pasi dhe kur të merren.

LUKSEMBURG

Rruga	1	Luksemburg	- Trier	33,788 km
“	2	“	- Remich	22,813 km
“	3	“	- Thionville	13,355 km
“	4	“	- Esch	19,655 km
“	5	“	- Longwy	25,027 km
“	6	“	- Arlon	18,118 km
“	7	“	- Diekirch	36,187 km
“	8		Mersch - Arlon	21,000 km
“	9	“	- Larochette	10,398 km
“	10	Remich - Grevenmacher, njohur si “route de la Moselle”		27,492 km
“	11	Luksemburg- Echternach		33,364 km
“	12	“- St. Vith, njohur si “route du nord”		88,900 km
“	13	Bous - Windhof, njohur si “route des 3 cantons”		41,450 km
“	14	Diekirch	- Grevenmacher	32,575 km
“	15	Ettelbruck- Bastogne		30,720 km
“	16	Diekirch	- Stavelot	44,100 km
“	17	“- Vianden		11,024 km
“	18	Marburg	- Antoniusshof	13,470 km
“	19	Diekirch - Wasserbillig, njohur si “route de la “Sure”		49,118 km
“	20	Cruchten	- Medernsch	5,500 km
“	21	Feulen - Grosbous		6,826 km
“	22	Arlon	- Colmar, njohur si “route de l’Attert”	27,760 km
“	23	Reichlange	- Martelange	19,300 km
“	24	Useldange	- Oberpallen	11,820 km
“	25	Wiltz	- Kautenbach	10,240 km
“	26	Mersch - Colmar, njohur si “route du Rost”		8,370 km
“	27	Ettelbruck	- Friedhof	5,253 km
“	28	Allenborn	- Bastogne	2,174 km
“	29	Wiltz	- Nothumb	4,550 km
“	30	Sandweiler- Bous, njohur zyrtarisht si “route de Remich”		10,980 km
“	31	Ehlerange	- Bascharage	6,715 km
“	32	Petange- Athus		2,830 km

“	33	Rodange - Athus	370 km

		Total	695,242 km

JUGOSLLAVIA

Rruga	1	Horgoc - Subotica – Beograd – Kragujevac	326 km
“	4	Jesonice – Lubjana	58 km
“		Lubjana – Rudnik	4 km
		Zagreb – Beograd	387 km
		Beograd – Pancevo	16 km
	5	Trieste – Planina	58 km
		Vërhnika – Lubjana – Domzhale	39 km
		Zhalec – Maribor – St. Ilj	87 km
	6	Sushak – Mërzlo Vodice	34 km
		Karlovac – Zagreb	60 km
		Zagreb – Cakovec	89 km

E/ECE/TRANSP/229/Add.1
E/ECE/TRANSP/SCI/91/Add.1
14 NËNTOR 1950
originali frëngjisht

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT TOKËSOR
NËNKOMITETI I TRANSPORTIT RRUGOR

MARRËVESHJA EUROPIANE

PËR ZBATIMIN E NENIT 23 TË KONVENTËS SË VITIT 1949 MBI TRAFIKUN RRUGOR, NË LIDHJE ME DIMENSIONET DHE PESHAT E MJETEVE QË LEJOHEN TË UDHËTOJNË NË RRUGË TË CAKTUARA TË PALËVE KONTRAKTUESE, NËNSHKRUAR NË GJENEVË MË 16 SHTATOR 1950

SHTOJCA 1

KOMUNIKATË NGA QEVERIA E BELGJIKËS

Qeveria e Belgjikës ka informuar Sekretariatit se të gjitha rrugët belge mund të hapen për mjetet me dimensione dhe pesha maksimale, që nuk i kalojnë ato të paraqitura në aneksin 7 të Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor.

Ky informacion i është përshtatur aneksit të Marrëveshjes europiane – “Rrugët e hapura për mjetet, dimensionet dhe pesha maksimale të të cilave nuk i kalojnë ato të paraqitura në aneksin 7 të Konventës së vitit 1949 mbi trafikun rrugor”.

LIGJ
Nr.9941, datë 26.6.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KONTRIBUTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AL-DIWAN AL-EMIRIT TË
SHTETIT TË KUAJTIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “RINOVIMI I SHESHIT
“SKËNDERBEJ” DHE RESTAURIMI I XHAMISË SË ETHEM BEUT NË TIRANË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kontributit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Al-Diwan Al-Emirit të shtetit të Kuvajtit për financimin e projektit “Rinovimi i sheshit “Skënderbej” dhe restaurimi i Xhamisë së Ethem Beut në Tiranë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5804, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE KONTRIBUTI
NDËRMJET AL-DIWAN AL-EMIRIT TË SHTETIT TË KUAJTIT DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje kontributi si në vijim:

Al Diwan- Al Emiri i Shtetit të Kuvajtit dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si Palët,

me dëshirën për të nxitur marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy vendeve;

duke vënë në jetë rezultatet e vizitës së Lartësisë së Tij, Sheikut Nasser Al – Mohammed Al – Ahmed Al – Sabah, Kryeministër i Shtetit të Kuvajtit, në Republikën e Shqipërisë në periudhën 12 – 14 dhjetor 2007,

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje kontributi është zgjerimi i kuadrit të bashkëpunimit ndërmjet të dy Palëve, zhvillimi dhe zbatimi i një projekti për rinovimin e sheshit “Skënderbej” dhe restaurimin e Xhamisë së Et’hem Beut në Bashkinë e Tiranës (në vijim referuar si projekti) me anë të një donacioni nga Lartësia e Tij, Sheiku Sabah Al – Ahmed Al – Jaber Al – Sabah, Emir i Shtetit të Kuvajtit, për financimin e këtij projekti.

Neni 2

Autoritetet zbatuese

Autoritetet zbatuese të kësaj Marrëveshjeje kontributi në të dy vendet janë Al-Diwan Al-Emiri

në Shtetin e Kuvajtit dhe Bashkia e Tiranës si agjenci zbatuese.

Kryetari të Bashkisë së Tiranës i delegohet përgjegjësia e përgjithshme për menaxhimin e projektit. Kryetari i Bashkisë do të emërojë personat e kontaktit dhe personelin e nevojshëm që do të sigurojë bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e përditshme të aktiviteteve për zbatimin e projektit.

Neni 3

Detyrimet e Al-Diwan Al- Emirit të Shtetit të Kuvajtit

Al-Diwan Al-Emiri i Shtetit të Kuvajtit merr përsipër si më poshtë:

1. Do të sigurojë mbështetje financiare për projektin dhe disbursimin e drejtpërdrejtë të pagesave, mbi bazën e kërkesës me shkrim të agjencisë zbatuese, në favor të shoqërive kontraktuese për projektimin, punimet dhe zbatimin e projektit, me kusht që shuma të mos kalojë shifrën e 5 000 000 euro (vetëm pesë milion euro).

Ky buxhet parashikohet të financojë aktivitetet e mëposhtme:

- përgatitjen e konkursit ndërkombëtar për zgjedhjen e konsulentit dhe kontratës së shërbimit për përgatitjen e projektit të hollësishëm dhe të gjitha dokumenteve teknike të nevojshme për realizimin e punimeve në shumën 500 000 euro dhe

- punimet për rinovimin e sheshit “Skënderbej” dhe restaurimin e Xhamisë së Et’hem Beut në Tiranë në shumën 4 500 000 euro.

2. Do të marrë përsipër të zgjedhë një shoqëri për zbatimin e punimeve të projektit.

3. Do të sigurojë zbatimin e projektit të rinovimit si kontakt parësor me kontraktues.

Neni 4

Detyrimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

A) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër sa më poshtë:

1. Të lehtësojë procedurat, praktikat dhe të sigurojë të gjitha lehtësitë e nevojshme për zbatimin e projektit.

2. Të përjashtojë këtë projekt nga të gjitha llojet e taksave të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta, si dhe nga detyrimet doganore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

A) Bashkia e Tiranës merr përsipër sa më poshtë:

1. Të organizojë punën për parashtrimin e termave të referencave, të tilla si: planifikimet, skicat dhe kërkesat teknike për zbatimin e projektit, si dhe të organizojë një konkurs ndërkombëtar për të zgjedhur idenë konceptuale më të mirë për hartimin e projektit të zbatimit.

2. Të zgjedhë një mbikëqyrës për punimet e rinovimit publik dhe të marrë përsipër punimet në mbarim të projektit të rinovimit.

3. Njohjen e emrit të donatorit në këtë projekt rinovimi si njohje ndaj donatorit.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe amendimet

1. a) Kjo Marrëveshje kontributi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet e vlefshme deri në përfundim të projektit.

b) Neni 4/A/2 i kësaj Marrëveshjeje kontributi do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Parlamenti i Shqipërisë.

2. Secila nga Palët mund ta amendojë këtë Marrëveshje gjatë fazave të zbatimit të projektit mbi bazën e miratimit të ndërsjellë të Palëve, me anë të nxjerrjes së një njoftimi për ndryshim me shkrim, para kryerjes së ndonjë ndryshimi.

3. Kjo Marrëveshje kontributi nuk kufizon në asnjë mënyrë Shqipërinë dhe Kuvajtin që të marrin pjesë në veprimtari të ngjashme, me agjenci publike ose private apo me organizata ose individë.

4. Çfarëdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet ndërmjet të dy Palëve përmes këshillimeve dhe bashkëpunimit brenda një kuadri të frymës miqësore që rregullon marrëdhëniet ndërmjet Palëve.

Bërë në qytetin e Tiranës, më 25 janar 2008, në dy kopje njëllorj autentike, në gjuhën arabe dhe angleze. Në rast ndryshimesh në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për

Për

Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë
(firma)

Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Lexuar dhe rënë dakord
Eduard Shalsi (firma)
Nënkryetar i Bashkisë së Tiranës

Al-Diwan Al- Emirin e
Shtetit të Kuvajtit
(firma)

Dr. Ismail Al – Shatti
Këshilltar i Kryeministrit të Lartësisë së Tij

UDHËZIM
Nr.25, datë 7.7.2008

**PËR KRITERET PROFESIONALE DHE PROCEDURAT E KONKURSIT PËR ZGJEDHJEN
E TREMBËDHJETË ANËTARËVE EKSPERTË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 54 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Anëtarët ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të jenë figura të njohura për kontributin në fushën e arsimit dhe shkencës, të zotërojnë së paku Diplomë të Nivelit të Dytë dhe të Nivelit të Dytë të Integruar dhe të kenë njohje të mirë të përvojës ndërkombëtare në fushën e arsimit parauniversitar.

II. Këta anëtarë për zgjidhen me konkurrim publik, nga një komision i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

III. Komisioni përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. një përfaqësues i Këshillit të Ministrave;
2. një përfaqësues i MASH-it;
3. një përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.

IV. Kriteret profesionale të përzgjedhjes janë si më poshtë:

1. diploma;
2. titulli, grada shkencore;
3. kualifikimet pasuniversitare të certifikuara;
4. botimet (libra, monografi, artikuj) etj.;
5. punësimi.

V. Konkursi të bëhet nëpërmjet dosjeve të dorëzuara brenda datës 15 korrik 2008, në komisionin e përzgjedhjes në MASH.

VI. Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve profesionale, rendit në një listë kandidatët sipas pikëve të fituara. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, trembëdhjetë nga kandidatët e klasifikuar.

VII. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.7.2008
Doli nga shtypi më 22.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë